

INTERSTORE SHPK –STATUTI

KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1** Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është INTERSTORE SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2** Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.3** Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

NENI 2 SELIA

- 2.1.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Faik Konica, Pallati nr.6, kati 3, ap,14, Njesia Bashkieke nr. 2, Tirane.
- 2.2** Asambleja e ortakeve mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1** Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetët që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjisllacionit shqiptar, dhe në veçanti:
 - Tregetim i pajisjeve: (elektronike, telekomunikacioni, kancelari, aksesore te ndryshem).

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është 100,000 (njëqindë mijë) lekë, i përbërë nga 1 (nje) kuote me vlerën 100,000 (njëqindë mijë) Lekë. Ortaku **Z.Gjergji Petko** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 100% të kapitalit me vlere 100,000 (njëqindë mijë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Gjergji Petko** shtetas Shqiptar, lindur në Prrenjas më 09 Janar 1987, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 036571946 dhe nr ID: I70109017L banues në Tirane, përsôn madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TËK TË TRETËT

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Asambleja e ortakeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një notëri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale.

KREU III NDRYSHIMI I KAPITALIT

NENI 8

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributëve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Asamblese se Ortakeve apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 9

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1** Asambleja e Ortakeve, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/vitëve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakeve, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitët e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakeve cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij NENI do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

KREU IV

ORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 10

STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1** Shoqëria tregtare INTERSTORE SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :

- Asambleja e Ortakeve të Shoqerise si organi vendimmarrës për shoqërinë;
- Administratorin

NENI 11

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

11.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për përsoneat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.2 Asambleja e Ortakeve të Shoqerise merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës “1” të këtij NENI, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentëve përkatës.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve

përcaktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve të Shoqerise. Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.

11.4 Nga ana e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organëve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- d) vendimet e marra në zbatim të NENIt 9 të këtij statuti.

11.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtë pasur dijeni për të.

NENI 12

MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS

12.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise zhvillohet në rastët e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”., nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.

12.2 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga kryesisht nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise ,administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.

12.3 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise,thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezulton ose

ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.

- 12.4** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij NENI jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

KREU V

ASAMBLEJA E ORTAKEVE, FINANCIMET

NENI 13

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 13.1** Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë përbehet nga Ortakui vetem **Z. Gjergji Petko** shtetas Shqiptar, lindur në Prrenjas më 09 Janar 1987, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 036571946 dhe nr ID: I70109017L banues në Tirane, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

NENI 14

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 14.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspërtit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

NENI 15

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 15.1** Të drejtat dhe detyrat e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë janë:
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë;

- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tëkstatët e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspërtit kontabël;
- Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

NENI 16

FINANCIMI I SHOQËRISË

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rastëve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (intëresa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

KREU VI

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 17

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:

Z. Gjergji Petko shtetas Shqiptar, lindur në Prrenjas më 09 Janar 1987, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. 036571946 dhe nr ID: I70109017L banues në Tiranë, përsôn madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

- 17.2** Në zbatim të këtij NENI, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetët publike dhe privatë, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha aktëve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç

atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organëve të tjera të Shoqërisë.

NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

18.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentëve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumentë përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) raportojë përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 19 PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT

19.1 Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 20 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

20.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqërise përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 21 KONTROLLI KONTABËL

21.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspërtë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakeve të Shoqërise do të emërojë një apo më shumë ekspërtë kontabël në ato rastë kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

21.2 Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22 VITI FINANCIAR

22.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 23 BILANCI DHE REZERVAT

23.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Ortakeve të Shoqërise të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afatëve të përcaktuara nga ligji.

23.2 Asambleja e Ortakeve të Shoqërise vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të vitëve të mëparshme.

- 23.3** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

NENI 24 PUNËSIMI NË SHOQËRI

- 24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

KREU VIII PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 25 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 25.1** Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise.
- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakeve të Shoqerise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacionëve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria priset në këto rastë:
- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
 - Me vullnëtin e ortakëve;
 - Me vendim të Gjykatës
 - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

NENI 26

PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare INTERSTORE SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 26.3** Në qoftë se Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

NENI 27

NJOFTIMET

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.

27.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjetëve elektronike vërtëtohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

27.3 Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU IX BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË NENI 28

28.1 Shoqëria INTERSTORE SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron të njëjtin aktivitet.

28.2 Gjithashtu shoqëria INTERSTORE SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

28.3 Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i për INTERSTORE SHPK shoqërisë që do të krijohet.

28.4 Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

KREU X DISPOZITA PËRFUNDIMTARE NENI 29 LIGJI I ZBATUESHËM

29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 30

- 30.1** Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
Të SHOQËRISË
INTERSTORE SHPK**

Gjergji Petko

Datë 17.02.2024